

VENDIM
Nr.781, datë 29.9.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.513, DATË 30.6.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
LINJËS 400 KV, TIRANË-PODGORICË, QARKU DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.513, datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 1890.7 (një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë shtatë) m², tokë bujqësore arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 156 980 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekësh.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 2 156 980 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS “400 KV ZONA E QARKUT DURRËS”

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR QARKUN DURRËS

N r.	Objekti	Shpronësimi definitiv										Shënimet
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. pronës m ²	Sipërfaqe shtylla për shpronësim definitiv m ²	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit	
	Rrethi Krujë											
	Bashkia Krujë (shtylla 249-259)								232.3		57,615	
	Komuna Thumanë (shtylla 260-263)								418.6		151,957	
	Bashkia Fushë-Krujë (shtylla 264-278)								844.1		1,874,995	
	Komuna Nikël (shtylla 279-283)								395.7		72,413	
	Shuma								1,890.7		2,156,980.0	
	Qarku Durrës								1,890.7		2,156,980.0	